



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 19, Datë 09.01.2020**

**PËR  
MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR GJYQTARIN E GJYKATËS SË  
APELIT KORÇË, {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin e “*moshës dhe gjendjes shëndetësore*”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Korçë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 15.01.2020.
3. Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtarit {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**